



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ...., datë .....2021

PËR

KRITERET E USHTRIMIT, TË MIRATIMIT DHE TË MONITORIMIT TË  
VEPRIMTARIVE KËRKIMORE-SHKENCORE NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, pikës 4 të nenit 20, të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", me propozimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
2. Veprimtaritë kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar, ushtrohen nga institucionet arsimore, institucionet e tjera dhe subjektet juridike e fizike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pyjet dhe me legjislacionin e posaçëm në fushën kërkimore-shkencore, sipas kriterëve të mëposhtme:
  - a) Personi fizik të ketë gradë shkencore në fushën e pyjeve dhe përvojë mbi 10-vjeçare, në fushën e pyjeve;
  - b) Personi juridik të ketë të paktën 3 specialistë pyjesh me kualifikim jo më të ulët se Master Shkencor dhe drejtuesin me gradë shkencore dhe përvojë mbi 10-vjeçare, në fushën e pyjeve;
  - c) Për institucionet arsimore, institucione të tjera dhe subjektet që kërkojnë të ngrenë baza eksperimentale dhe didaktike në fondin pyjor publik, drejtuesi i grupit studimor, të ketë mbi 10 vjet eksperiencë në fushën e pyjeve;
  - d) Të ketë mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për rastin studimor/kërkimor që do ushtrojë;
  - e) Të kryejë pagesën sipas tarifave të përcaktuara në aktin nënligjor, për të ardhurat e gjeneruara nga tarifatat në zbatim të ligjit nr.57/2020, "Për pyjet".
3. Për miratimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në fondin pyjor bashkiak, si pjesë e fondit pyjor kombëtar, subjektet paraqesin kërkesën me shkrim për miratim pranë bashkisë përkatëse, që ka në pronësi këtë fond.
4. Kërkesa me shkrim shoqërohet me dokumentacionin që verteton plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 2, si dhe nga tre shtojca, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi:
  - a) Shtojca nr. 1, pasqyron detaje mbi aplikuesit;
  - b) Shtojca nr. 2, pasqyron detajet mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore;
  - c) Shtojca nr. 3, vetëdeklarimi.

5. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, brenda 15 ditëve punë nga data e dorëzimit, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur.
6. Në rast se nga ana e strukturave përgjegjëse për pyjet në bashki, konstatohet se kërkesa e paraqitur nga subjekti kërkuar nuk plotëson kërkesat e pikës 4, të këtij vendimi, subjektit i kërkohet plotësimi i dokumentacionit brenda 10 ditëve. Në rast se subjekti nuk paraqet dokumentacionin plotësues brenda afatit të kërkuar, kërkesa refuzohet.
7. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, mbështetet në planet e mbarështimit për shqyrtimin e kërkesës së subjektit, për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, dhe në rast se kërkesa është në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për pyjet si dhe parashikimet e këtij vendimi, miraton të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore.
8. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki njofton Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, mbi ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.
9. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, monitorojnë veprimtarinë kërkimore-shkencore të subjektit, dhe në rast se konstatohen shkelje gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore, marrin masa administrative në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, për mospërbushje dhe mosrespektim të kushteve të kërkesës dhe aktivitetit të miratuar për tu ushtruar.
10. Në rastet e studimeve, marrjes dhe programeve të tjera lidhur me përdorimin e bazës gjenetike të florës/faunës, bashkia për dhënien e miratimit për ushtrimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fondin pyjor kombëtar dhe subjekti që ushtron këtë veprimtari, duhet të bazohet në kërkesat e ligjit nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.
11. Subjekti pas përfundimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, dorëzon në bashki dhe në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve një raport përmbledhës mbi rezultatet e marra. Agjencia dërgon çdo 6 muaj informacionin e marrë, në ministrinë përgjegjëse për pyjet.
12. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki administron regjistrin e kërkesave dhe miratimeve për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe i vënë në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe ministrisë përgjegjëse për pyjet, në fund të çdo viti ose sa herë kërkohet prej tyre.
13. Në rast se kërkesa për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet për pyjet në pronësi private, subjekti i paraqet kërkesën pronarit si edhe bashkisë brenda territorit të së cilës gjendet sipërfaqja pyjore. Kërkesa miratohet nga bashkia përkatëse, bazuar në parashikimet e këtij vendimi, pas marrjes së dakordësisë nga pronari.
14. Kur veprimtaria kërkimore-shkencore kërkohet në fond pyjor të zonave të mbrojtura mjedisore, zbatohen përcaktimet e bëra në VKM nr.302, datë 10.05.2019, "Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në Zonat e Mbrojtura Mjedisore.
15. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

FORMULARI I APLIKIMIT

**KËRKESË  
PËR TË DREJTËN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARIVE  
KËRKIMORE-SHKENCORE  
NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR**

DETAJE TË APLIKUESIT/APLIKUESVE (zgjidh opsionin)

1.1 Emër Mbiemër:	1.1.1 Pozicioni:
1.2 Institucioni (emërtimi dhe NIPT):	
1.3 Adresa:	1.3.1 Kodi postar:
1.4 Nr i telefonit/ e-mail:	
1.5 Lista e anëtarëve të stafit pjesëmarrës në studimin kërkimor-shkencor, grada shkencore, pozicioni:	

1.6 Titulli i studimit/projektit:
1.7. Bashkia:
1.8 Ekonomia Pyjore dhe ngastra në të cilën zhvillohet veprimtaria (me treguesit kadastralë):
1.9 Kordinatat gjeografike të zonës (KRRGJSH):
1.10 Përshkrimi i shkurtër i projektit:
1.9.1 Metodologjia e studimit/projektit:
1.9.2 Fillimi dhe mbarimi i projektit:
19.3. Data e dorëzimit të raportit përfundimtar:



VETËDEKLARIM

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_

i/e datëlindjes \_\_\_\_\_

(emër/atësi/mbiemër)

(datë/muaj/vit)

Nëse aplikanti përfaqëson një institucion duhet të saktësojë pozicionin që mban

- 
1. Deklaroj, me vullnet të lirë e të plotë, se mbaj përgjegjësi personale për të gjithë informacionin që është plotësuar në këtë formular dhe se veprimtaria e kërkimit-shkencor nuk do të ketë ndikime negative në drejtim të prishjes së ekuilibrave natyrorë dhe se pas përfundimit të projektit do të dorëzojë pranë bashkisë \_\_\_\_\_ dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, raportin përmbledhës për rezultatet e arritura gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie.

Deklaruesi

Datë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Firma